

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6852
E shtunë, 18 mars 2023
çmimi 0.40 €

Kosova pranon këstin e parë financiar nga BE-ja në vlerë 67.5 milionë euro



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E SHTUNË) NË OHËR MBAHET TAKIMI NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

ESCOBARI SHPREH OPTIMIZËM PËR PAQE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË



I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të premtën se është optimist për rezultate pozitive në takimin e së shtunës në Ohër ndërmjet

kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Ai i ka bërë këto komente të premtën në Prishtinë gjatë takimit që ka pasur me liderë

të shtetërorë të Kosovës. Escobari ka theksuar se propozimi evropian jep një mundësi të jashtëzakonshme për paqe të qëndrueshme mes dy vendeve

RAPORTI I OKB-së: RUSIA KA KRYER TORTURË DHE KRIME LUFTE NË UKRAINË



MUSTAFA: KURTI NA CILËSOI TRADHTARË, TANI SOLLI NJË LLOJ AUTONOMIE PËR SERBËT



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



GIRESSE PUBLIKON LISTËN E FUTBOLLISTËVE PËR NDESHJET E MARSIT

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Raporti i OKB-së: Rusia ka kryer torturë dhe krime lufte në Ukrainë

NYU-JORK, 17 MARS - Rusia ka kryer shkelje në shkallë të gjerë të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe normave humanitare që prej nisjes së pushtimit të Ukrainës më 24 shkurt 2022. Disa prej këtyre shkeljeve përbëjnë krime lufte, u tha në raportin e publikuar nga Komisioni i Pavarur Hetimor Ndërkombëtar që mbështetet nga OKB-ja.

Raporti bëri me doje se shkeljet përfshijnë vrasje të qëllimshme të civilëve të paarmatosur që paraqesin krime lufte, por edhe tortura, ndalime të paligjshme, përdhunime dhe forma të tjera të dhunës seksuale dhe dëbime të dhunshme të fëmijëve ukrainas në Rusi nga zonat nën kontrollin e Moskës.

Komisioni, po ashtu, tha se vala e sulmeve ruse në shkallë të gjerë ndaj infrastrukturës energetike të Ukrainës që nga tetori i kaluar ka bërë që miliona persona në Ukrainë të mbesin pa rrymë apo ngrohje në periudha të gjata

kohore gjatë dimrit. Kjo, sipas këtij komisioni, mund të përbëjë krim kundër njerëzimit. Në raportin e komisionit u tha se sulmet ndaj infrastrukturës duhet të hetohen më tej.

Komisioni, që ka mbështetjen e Kombeve të Bashkuara, përbëhet nga tre ekspertë të pavarur të drejtave të njeriut. Ky komision u themelua gjatë një debati urgjent që u mbajt pas nisjes së pushtimit të paprovokuar rus të Ukrainës.

Raporti bazohet në qindra intervista, imazhe satelitore dhe vizita në qendrat e ndalimit dhe varreza. Aty përmendet se përdorimi i armëve shpërthyes nga forcat ruse në zonat e populluara është një prej shkaktarëve kryesorë të viktimitave civile, që ka treguar "një mospërfillje ndaj dëmtimit të civilëve dhe shkakimit të vuajtjeve".

Raporti tha se anëtarët e Komisionit "janë tronditur nga niveli i madh i shkatërrimit" që

panë gjatë vizitave të tyre në terren.

Në raport janë identifikuar një "sërë" rastesh të përdhunimit dhe dhunës seksuale nga autoritetet ruse në zonat që kanë marrë nën kontroll.

Dhunat seksuale është kryer gjatë vizitave shtëpi me shtëpi dhe gjatë ndalimit të paligjshëm të viktimitave. "Dhunat seksuale, që përbën torturë, dhe kërcënimet ndaj këtyre grave dhe burrave, kanë qenë aspekte të rëndësishme të torturës së kryer nga autoritetet ruse", u tha në raport.

Transferimi dhe dëbimi i fëmijëve ukrainas në Rusi "përbën krim lufte", tha raporti, duke shtuar se shumë fëmijë nuk mund të kontaktonin me familjarët e tyre dhe "mund të kenë humbur përgjithmonë kontaktin me ta".

Vonesat në procesin e riatdhesimit të civilëve mund të përbëjnë, po ashtu, krim lufte, u tha në raport. Komisioni, po ashtu, "ka dokumentuar një



numër të vogël të shkeljeve të kryera nga forcat e armatosura ukrainase, përfshirë sulmet pa dallim dhe dy incidente janë cilësuar si krime lufte kur të burgosurit rusë të luftës janë qëlluar, plagosur dhe torturuar", u tha në raport.

Rekomandimi kryesor i komisionit është që "të gjitha

shkeljet dhe krimet të hetohen dhe përgjegjësit të dalin para drejtësisë, qoftë në nivelin kombëtar apo ndërkombëtar".

Rusia vazhdimisht ka hedhur poshtë akuzat se ka kryer mizori apo ka shënjestruar civilët në Ukrainë, pavarësisht se ka dëshmi të shumta që mbështetin këto akuzat.

Gjukanoviçi shpërndan Parlamentin e Malit të Zi, zgjedhjet më 11 qershor

PODGORICË, 17 MARS - Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviçi, shpalli 11 qershorin datë për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare. Vendimi vjen një ditë pasi Gjukanoviçi, duke iu referuar Kushtetutës së vendit, nxori dekretin për shpërndarjen e përbërjes së deritashme të Kuvendit.

Vendimi për shpërndarjen e Parlamentit vjen tri ditë para mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale në të cilat garon edhe Gjukanoviçi.

Sipas njoftimit të Presidencës, dekreti për shpërndarjen e Parlamentit të Malit të Zi u nënshkrua në bazë të nenit 92, pika 3 e Kushtetutës së Malit të Zi.

Qeveria aktuale e Dritan Abazoviçit para shtatë muajsh u rrëzua nga një mocion mosbesimi. Ekzekutivi u rrëzua pasi Abazoviçi nënshkroi Marrëveshjen Bazë me Kishën Ortodokse Serbe në gusht të vitit



2022.

Sot, 90 ditë pasi janë miratuar ndryshimet në Ligjin për President, në bazë të të cilave Miograd Llekqi u propozua për mandatar të qeverisë, ky legjislacion u botua në Gazetën Zyrtare.

Llekqi dështoi ta siguronte

mbështetjen e 41 nga 81 deputetët e Parlamentit dhe të formonte qeverinë e re brenda afatit të caktuar prej 90 ditësh.

Gjukanoviçi kishte thënë se ndryshimet në Ligjin për President ishin kundërthënëse dhe këshilltarët e tij ligjorë e dërguan atë

në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë.

Ligji u ndryshua në dhjetor nga shumica parlamentare që përbëhet nga Fronti Demokratik pro-rus, Demokratët, Partia Popullore Socialiste dhe Lëvizja URA.

Përmes ndryshimeve ligjore, shumica parlamentare mori autoritetin kushtetues të presidentit të shtetit, pasi Gjukanoviçi, për arsye formale, refuzoi që ta mandatonte Llekqiin për formimin e qeverisë së re.

Partnerët ndërkombëtarë, veçmas Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, vazhdimisht i kanë bërë thirrje shumicës parlamentare të mos tentojë të krijojë qeverinë e re bazuar në ligjin e ndryshuar, duke argumentuar se do të vihej në pikëpyetje legjitimiteti i ekzekutivit. Ata këtë mendim e bazuan edhe në opinionin negativ që dha Komisioni i Venencias sa iu përket ndryshimeve në Ligjin për President.

Zgjedhjet e fundit parlamentare në Mal të Zi u mbajtën më 30 gusht të vitit 2020.

Zgjedhjet e reja që do të shpallen do të jenë të gjashtat që Mali i Zi ka mbajtur që nga pavarësia më 2006.

Slovakia vendos t'i japë Ukrainës avionë luftarakë MiG-29

BRATISLAVË, 17 MARS - Qeveria e Sllovakisë miratoi të premten një plan për t'i dhënë Ukrainës 13 avionë luftarakë të kohës sovjetike, MiG-29, duke u bërë vendi i dytë anëtar i NATO-s që dëgjon kërkesat e qeverisë ukrainase për avionë luftarakë, për të ndihmuar në mbrojtjen e saj kundër pushtimit të Rusisë. Kryeministri sllovak Eduard

Heger, duke njoftuar vendimin në një konferencë për medie, tha se qeveria e tij ishte "në anën e duhur të historisë".

Më herët Heger shkroi në "Twitter" se ndihma ushtarake ishte thelbësore për të siguruar që Ukraina të mund ta mbronte veten dhe të gjithë Evropën kundër Rusisë.

Polonia njoftoi të enjten se

edhe ajo do t'i japë Ukrainës disa avionë MiG-29, duke filluar me katër që pritet të dorëzohen në ditët në vijim. Si Polonia, ashtu edhe Sllovakia, ishin shprehur të gatshme edhe më parë t'i plotësonin kërkesat e Ukrainës për avionë ushtarakë, por vetëm si pjesë e një koalicioni më të gjerë ndërkombëtar.



Rama: Pezullohen 'pasaportat e arta', konsultime me BE-në për amnistinë fiskale

TIRANË, 17 MARS - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se procesi për lëshimin e të ashtuquajturave "pasaporta të arta" është pezulluar për sa kohë kjo çështje po vlerësohet nga Gjykata Evropiane. Për këtë ngjarje ai ka njoftuar në përfundim të Këshillit të Stabilizim-Asociimit, BE - Shqipëri, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme, Josep Borrell dhe komisionari për zgjerim, Oliver Varhelyi.

Rama ka thënë, po ashtu, se qeveria e tij nuk është tërhequr nga amnistia fiskale, porse po punon për këtë me ekspertët evropianë.

Këshilli i Stabilizim Asocimit është forumi më i lartë dypalësh në mes të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë i cili mbledhet një herë në vit për ta analizuar ecurinë e vendit kandidat në procesin e integritetit. Për herë të parë kjo mbledhje është mbajtur në Tiranë e jo në Bruksel apo Luksemburg si zakonisht. "Me këtë ne duam të japim një sinjal të qartë dhe të fuqishëm politik për angazhimin e Bashkimit Evropian ndaj rrugëtimit shqiptar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe e përdorim Këshillin e Stabilizim Asocimit si ndërveprimin institucional më të rëndësishëm ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë", ka thënë Rama.

Ndërsa është vlerësuar ecuria e reformave në vend, gjatë takimit është theksuar nevoja për përpunim të mëtejshëm. BE-ja ka nënvizuar se përpjekjet për të krijuar një histori solide në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të shtohen,



përfshirë atë në nivel të lartë.

Këshilli i Stabilizim Asocimit rrok thuasje në 360 gradë problematikat dhe përparimin e vendit kandidat. Gjatë kësaj mbledhjeje është trajtuar dhe çështja e të ashtuquajturave "pasaporta të arta", të cilat lëshohen kundrejt shumave të caktuara që investohen nga të huajt e për të cilën Brukseli kishte shfaqur shqetësim të vazhdueshëm. Por kryeministri Rama ka thënë se është vendosur pezullimi i procesit. "Ka një çështje në Gjykatën Evropiane. Ne nuk do

ta nxjerrim më këtë iniciativë në tavolinë pa parë si do të përfundojë çështja në Gjykatën Evropiane. Nëse Gjykata Evropiane vendos kundër pasaportave të arta, kjo është një çështje e mbyllur. Nëse Gjykata Evropiane vendos për, atëherë çdo vend do ta bëjë zgjedhjen e vet", ka thënë Rama.

Tjetër çështje në mes të Tiranës dhe Brukselit ka qenë ajo e amnistisë fiskale. "Nuk heqim dorë thjesht sepse kjo nuk është një gjë e mirë në parim, sepse ne kemi të gjitha arsyet tona për të menduar

që kjo është gjëja e duhur për Shqipërinë por ama, nga ana tjetër, ne duam që këtë gjë ta bëjmë së bashku, prandaj ju falënderojmë për ekspertizën dhe duam t'i shkojmë deri në fund procesit të dialogut dhe përmirësimit të drafteve. Sot është një draft komplet tjetër nga ai që ishte në fillim falë ekspertizës që na keni ofruar", është shprehur kryeministri shqiptar.

Sa i përket lejimit të kultivimit të kanabisit për qëllime mjekësore, Rama ka thënë se kanë përfunduar konsultimet dhe

procesi do të vazhdojë më tej në parlament "duke pasur shumë të qartë jo vetëm se si e shkruajmë, por edhe se si e zbatojmë dhe për këtë të gjithë elementët e monitorimit janë mirëmenduar, por sigurisht do të gjykohe në praktikë".

Kryeministri shqiptar ka kërkuar mbështetje më të madhe financiare nga Bashkimi Evropian për rajonin e Ballkanit, i cili, ka thënë Rama, nuk mund t'u rezistojë goditjeve të krizës së krijuar si pasojë e agresionit rus në Ukrainë.

Mustafa: Kurti na cilësoi tradhtarë, tani e solli një lloj autonomie për serbët

PRISHTINË, 17 MARS - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me Serbinë, kryeministri Albin Kurti do t'i zbatojë të gjitha marrëveshjet që i ka kritikuar më parë e për të cilat i ka quajtur edhe tradhtarë.

Mustafa në emisionin 'Pressing' në T7 ka thënë se Kurti i ka kritikuar për nënshkrimin e marrëveshjeve të vitit 2013 e 2015, duke i shpallur si tradhtarë e duke i rrezikuar ata. "Me këto marrëveshje do të zbatohen të gjitha marrëveshjet që janë kritikuar dhe në të cilat ne jemi cilësuar në forma të ndryshme. Unë në këtë rast nuk po preokupohe shumë se çfarë ka thënë Kurti për ne, si na ka kritikuar, si na ka rrezikuar para opinionit, sepse kemi qenë të rrezikuar nëse ne jemi



shpallur tradhtarë, se ne i kemi bërë dëm Kosovës. Në këtë marrëveshje do të implementohet çdo gjë që është

arritur më parë si marrëveshje", ka thënë Mustafa.

Mustafa ka shtuar se kjo marrëveshje që tani po e

nënshkruan Kurti do të sjellë një lloj autonomie për serbët. "Marrëveshja për Asociacionin do të përfshijë edhe elemente të

tjera që nuk i përfshin marrëveshja e vitit 2013 që është ratifikuar në Kuvend, aq më pak i përfshin parimet që kemi arritur në vitin 2015. Pika 7 flet për një lloj vetëqeverisje të serbëve në Kosovë, nuk flitet për vetëqeverisje të komunave, por vetëqeverisje të komunitetit serb, që nënkupton një lloj autonomie të serbëve në Kosovë", ka thënë ai.

Megjithatë, Mustafa thotë se Kurti duhet të jetë i kujdesshëm në procesin e zbatimit, pasi mund të ketë gjëra që mund t'i bëjnë dëm Kosovës. "Edhe Kurti edhe të gjithë ne, pasi është fjala për një marrëveshjeje që e prek gjithë Kosovën, duhet të jemi të kujdesshëm, çfarë po pranojmë në procesin e zbatimit, pasi mund të ketë gjëra që në atë proces mund t'i bëjnë dëm Kosovës", është shprehur Mustafa.



SOT (E SHTUNË) NË OHËR MBAHET TAKIMI NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Escobari shpreh optimizëm për paqe në mes të Kosovës dhe Serbisë

I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të premtën se është optimist për rezultate pozitive në takimin e së shtunës në Ohër ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Ai i ka bërë këto komente të premtën në Prishtinë gjatë takimit që ka pasur me liderë të shtetërorë të Kosovës. Escobari ka theksuar se propozimi evropian jep një mundësi të jashtëzakonshme për paqe të qëndrueshme mes dy vendeve

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 MARS - I dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të premtën se pret takim produktiv në Ohër ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 18 mars. "Jam shumë optimist për një zgjidhje paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ne kemi për qëllim të mbështesim çdo rezultat që sjell më afër paqen e rajonit dhe shton mundësitë për Kosovën dhe Serbinë, si dhe gjithë rajonin, që të bëhen anëtare të

plota të komunitetit euroatlantik. Mendojmë se ky propozim evropian, i lehtësuar përmes dialogut të BE-së, jep një mundësi të jashtëzakonshme për paqe të qëndrueshme mes dy vendeve", ka thënë ai.

Escobar ka shtuar se "ShBA-ja, si mbështetësja më e madhe e Kosovës në botë, ka për qëllim që kjo të funksionojë për Kosovën dhe rajonin, që të zhblokohen burimet që Ballkani ia siguron vetes". Escobari këto komente i ka bërë në një konferencë për medie me presidenten e Kosovës, Vjosa

Osmani, në ditën e dytë të vizitës së tij në Prishtinë. Presidentja Osmani ka thënë se Kosova shkon drejt Ohrit me mendësinë se një "marrëveshje e drejtë, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ku trajtohem si dy shtete të barabarta, është e vetmja mënyrë për të siguruar paqe afatgjatë, stabilitet dhe prosperitet në rajon". "Pritjet e mia, si presidente e Kosovës, janë që marrëveshja do të sjellë rezultate konkrete të prekshme për Kosovën. Rrjedhimisht, do ta sigurojë integrimin e Kosovës në institucionet euroatlantike, do ta sigurojë integrimin gjithëpërfshirës të komunitetit serb në institucionet e Republikës. Kjo do të rezultojë me shpërbërjen efektive të menjëhershme të të gjitha strukturave ilegale të Serbisë", ka deklaruar Osmani. Ajo ka thënë se beson se kjo marrëveshje përfshin parime të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, "të cilat do ta shtrojnë rrugën drejt njohjes reciproke". Escobari është takuar edhe me kryetarin e Kuvendit të Kosovës,

Glauk Konjufca, si dhe me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Konjufca, pas takimit me Escobarin, ka thënë se Kosova është e përkushtuar për fqinjësi të mirë, paqe dhe stabilitet në rajon.

Përmes një njoftimi për medie nga zyra e tij, Konjufca citohet të ketë thënë gjatë takimit se fokusi i dialogut është njohja e plotë e Kosovës, dhe se "çfarëdo marrëveshje që mund të arrihet në procesin e dialogut me Serbinë duhet të respektojë plotësisht sovranitetin, integritetin territorial dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës".

Escobari së bashku me Kurtin kanë diskutuar për takimin e së shtunës në Ohër të Maqedonisë së Veriut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë bazuar në propozimin Evropian, përgatitjet rreth tij dhe pritjet nga ai takim. Kurti e ka falënderuar Escobarin për angazhimin dhe kontributin e tij dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialog. "Propozimi evropian është cilësuar dhe

pranuar nga Kosova si bazë e mirë dhe platformë solide për të ecur përpara drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me njohjen reciproke në qendër. Të përkushtuar, konstruktiv dhe kreativ, delegacioni qeveritar i Kosovës udhëton për në Ohër me vullnet të mirë, qëllime të mira dhe besim të mirë", është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Këto takime në mes të emisarit amerikan dhe udhëheqësve institucionalë të Kosovës janë zhvilluar një ditë para se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të takohen në Ohër të Maqedonisë së Veriut, në raundin e ri të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Një ditë më parë, i dërguari i posaçëm i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka takuar edhe liderët e partive opozitare. Dy prej partive më të mëdha opozitare në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, kanë

Vitia vizitoi institutet paraklinike në QKUK dhe morgun

PRISHTINË, 17 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i shoqëruar nga u.d drejtresha e ShSKUK-së, dr. Nargize Arenliu-Hoxhaj, udhëheqësja e Bordit, dr. Aida Rexhepi dhe anëtarja e Bordit, dr. Agreta Gecaj, vizitoi hapësirat e instituteve paraklinike për të parë nga afër realizimin e projektit që kishte për qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe investimet në infrastrukturë.

Në këtë projekt në vlerë të 654 mijë eurove janë të përfshira pajisjet mjekësore dhe inventarizimi i dorëzuar në institutet paraklinike, furnizimi dhe instalimi i tyre, pajisjet fikse të mobilizuara, pajisjet lëvizëse të specializuara dhe furnizimet për institutet paraklinike.

Gjatë takimit ministri Vitia u njoftua



me shërbimet që ofrohen në këto klinika si dhe premtoi se do të

merren për bazë kërkesat për investime të mëtutjeshme për

përmirësimin e kushteve të punës me qëllim të shërbimeve sa më të

mira. "Shërbimet paraklinike janë shumë të rëndësishme. Jam shumë i interesuar për t'u dhënë një dimension tjetër këtyre shërbimeve. Ne jemi të përkushtuar që çdo nevojë për investime që vjen nga ju së pari, ne t'i përgjigjemi sa më mirë e shpejt që është e mundur. Jemi duke bërë një plan, përveç investiv, edhe në racionalizimin e resurseve njerëzore, për ta racionalizuar kohën e cila do të mund të përdoret në të mirë të shërbimit të qytetarëve", ka thënë ministri Vitia.

Ky projekt ishte paraparë të realizohet në kuadër të bashkëpunimit me Bankën Botërore për mirëmbajtjen e kapaciteteve për Covid-19, e ku një prej aktiviteteve ishte edhe ndërtimi i instituteve paraklinike.

Petrit Selimi: Kosova s'mund të anëtarësohet në KiE as pas marrëveshjes me Serbinë, vendosen kushte të reja

PRISHTINË, 17 MARS - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Petrit Selimi, ka thënë se Kosova nuk do të mund të anëtarësohet në Këshillin e Evropës as pasi ta nënshkruajë marrëveshjen bazë për normalizimin e raporteve me Serbinë. Sipas Selimit, për anëtarësim në KiE Kosovës do t'i vihen edhe disa kushte të tjera, siç janë zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pronat e Manastirit të Deçanit dhe miratimi i Kodit Civil, ku hapet

rruga që me ligj të regjistrohen bashkësitë civile të së njëjtës gjini. "Kosova nuk do të bëhet menjëherë anëtare e Këshillit të Evropës pasi ta nënshkruajë marrëveshjen me Serbinë. Rruga do të hapet, por më shumë kushte do t'i shtohen për votën e anëtarësisë momentale, përfshirë çështje si vendimi për Manastirin e Deçanit, miratimi i martesave të gjinisë së njëjtë e të tjera", ka shkruar Selimi në "Twitter".



shprehur kundërshtoi lidhur me propozimin evropian pasi, sipas tyre, aty nuk përfshihet njohja e ndërsjellë, ndërkaq në të palët pajtohen t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog, që nënkupton edhe marrëveshjet për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ndërkaq Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka shprehur

mbështetjen e saj për propozimin evropian. BE-ja ka thënë se Asociacioni është kushti kryesor për zbatimin e propozimit evropian, ndërkaq Escobari gjatë konferencës për medie në Beograd më 16 mars ka thënë se formimi i Asociacionit është më afër sesa ishte një muaj më parë. "Mund të them se bisedimet tona me Qeverinë e Kosovës po

bëhen gjithnjë më produktive dhe realiste. Shpresoj se ne jemi shumë më afër kësaj sesa disa javë më parë", ka deklaruar Escobar. Zyrta i lartë amerikan, po ashtu, ka thënë se do të dëshironte që marrëveshja përfundimtare për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës e Serbisë të arrihet këtë vit.

Në propozimin evropian për normalizim, që përbëhet nga 11 nene, nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite as marrëveshjet për themelimin e Asociacionit, as njohja e ndërsjellë, që Qeveria e Kosovës ka thënë se duhet të jetë në qendër të një marrëveshjeje eventuale për normalizim të raporteve. Megjithatë, në nenin 2 të propozimit përmendet që

palët duhet të respektojnë pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të njëra-tjetrit. Propozimi, po ashtu, përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruese.



Ibrahimi: Qeveria ua pezullon komunave 37.5 milionë euro

PRISHTINË, 17 MARS - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahimi, ka thënë se rreth 37.5 milionë euro nuk do t'u barten komunave në vitin 2023 dhe këto mjete do të mbahen të pezulluara nga Qeveria e Kosovës.

Ibrahimi në një deklaratë për "Telegrafin" ka thënë se në bazë të Ligjit për Ndarje Buxhetore për Vitin 2023, në pikën 6 të nenit 9 për të hyrat vetjake të komunave, thuhet se bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetjake të komunave nga viti fiskal 2022, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2023 sipas autorizimeve të LMFPP-së, duke ruajtur strukturën e shpenzimeve dhe aprovuar me vendim të Kuvendit të Komunës. "Kjo është hera e parë që një dispozitë e tillë parashihet me ligjin mbi ndarje buxhetore sepse në vitet

e kaluara është thënë se të hyrat vetjake mund të barten nga vitet fiskale paraprake e jo vetëm nga një vit paraprak. Kjo i bie që komunave do t'u barten të hyrat nga viti 2022 në vitin 2023, por assesit të hyrat vetjake nga vitet paraprake, pra të vitit 2021, nuk do t'u barten komunave në vitin 2023. Me këtë rast rreth 37.5 milionë euro nuk do t'u barten komunave në vitin 2023 dhe këto mjete do të mbahen të pezulluara nga Qeveria e Kosovës", ka theksuar Ibrahimi, duke shtuar se këto mjete, të cilat janë të dedikuara për investime kapitale për përmirësimin e jetës së qytetarëve, nuk do të mund të ndodhin. "Zgjidhja e vetme e këtij problemi është amandamenti i Ligjit për Ndarje Buxhetore, në të cilin pika 6 e nenit 9 do të ndryshohet dhe t'u mundësohet komunave bartja e të hyrave vetjake edhe nga viti 2021", ka thënë Ibrahimi.



Mbi 61 000 vizita mjekësore specialiste janë kryer gjatë vitit 2022 në Spitalin e Gjilanit



GJILAN, 17 MARS - Mbi 61 700 vizita mjekësore specialiste janë kryer gjatë vitit 2022 në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, në 19 profile të ndryshme mjekësore, ndërkaq në dy muajt e parë të vitit 2023 janë kryer 8 300 vizita mjekësore.

Brenda ditës stafi mjekësor i Spitalit të Gjilanit kryen 220 vizita mjekësore, përderisa brenda javës 1 100 vizita mjekësore, kurse për një muaj 4 500 vizita.

Në ambulancat specialiste shërbime mjekësore ofrojnë 68

mjekë specialistë të lëmenjve të ndryshëm dhe 29 infermierë.

Pacientët që kanë nevojë për shërbime specialiste të profileve të ndryshme mjekësore nga rajoni i Gjilanit paraprakisht duhet të kenë udhëzim nga qendrat e mjekësisë familjare dhe termini bëhet përmes sistemit kompjuterik.

Ambulancat specialiste të këtij spitali ofrojnë shërbime në kushte moderne, të rinovuara dhe të pajisura me aparaturë të nevojshme mjekësore.

Përparim Rama viziton Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë



PRISHTINË, 17 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me hoxhën Halil Kastrati, kanë vizituar Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë. "Koha që kaloj në Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë më kujton se moshën është vetëm një numër, por mençuria e përvoja që

vjen me të është e paçmuar. Është e rëndësishme që ne të ofrojmë një vend të rehatshëm dhe të sigurt për personat e moshuar të cilët kanë nevojë për kujdes dhe të ndihen si në shtëpinë e tyre", ka thënë Rama. Ai ka theksuar se ky vend duhet të ofrojë një ndjenjë bashkësie në mënyrë që të

luftohet një nga problemet më të mëdha me të cilin ballafaqohet ky komunitet - vetmia. "Shumë i lumtur që këtë vizitë e bëmë bashkë me hoxhën Halil Kastratin, i cili, si pionier në këtë aspekt, na dha ide fantastike për investime të reja në këtë shtëpi", ka deklaruar Rama.



Totaj i shpreh mirënjohje Luksemburgut për përkrahjen e Prizrenit me projekte

PRIZREN, 17 MARS - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur shefin e misionit të Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, me të cilin ka diskutuar për marrëdhënie bilaterale dhe bashkëpunime në

fushën e kulturës e të sportit. Kryetari Totaj i ka shprehur mirënjohje për kontributin e vazhdueshëm Luksemburgut për mbështetjen e projekteve të ndryshme në komunën e Prizrenit.

Policia dhe KFOR-i mbajnë ligjëratë me nxënës për edukimin medial

PRISHTINË, 17 MARS - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me KFOR-in amerikan - Regional Command East, kanë mbajtur një ligjëratë për edukimin medial për nxënësit e shkollës American School of Kosova. Qëllimi i ligjëratës ka qenë që nxënësit e kësaj shkolle të mësojnë më shumë për punën e Zyrave për Media dhe

Marrëdhënie me Publikun në Policinë e Kosovës si dhe në Komandën e Lindjes së KFOR-it (USA KFOR).

Gjatë kësaj ligjërate u fol për edukimin mediatik, llojet e ndryshme të medieeve, kujdesin për atë që lexojmë, kuptojmë, si dhe fëmijët u udhëzuan që për të pasur informim të drejtë dhe korrekt,

duhet të shikohen burimet e informacionit, qëllimi i tyre, autorët dhe detaje të tjera rreth një lajmi të plasuar në platforma të ndryshme mediale. Fëmijët në ASK me shumë entuziazëm shtruan shumë pyetje për temën e ligjërimit si dhe për profesionin e ushtarit dhe policit.



Minat vazhdojnë të kërcënojnë jetën e banorëve të Kosovës

Bashkimi Evropian (BE) është duke financuar një projekt të çminimit në Kosovë në vlerë prej 3.9 milionë eurosh. Operacionet do të kryhen Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë, Belincë, Rastavicë dhe Kosharë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 MARS - Në Graçanicë është shënuar fillimi i projektit të çminimit në vlerë prej 3.9 milionë eurosh financuar nga Bashkimi Evropian. Partnerët zbatues janë HALO Trust dhe Ndihma Popullore Norvegjeze (NPA) me NPA që udhëheq këtë projekt i cili do të merret me pastrimin e bombave kasetore dhe mjeteve të tjera shpërthyes nga zonat e kontaminuara. "Edhe pse është arritur progres i konsiderueshëm në aktivitetet e pastrimit të minave, minat vazhdojnë të jenë një kërcënim për banorët dhe jetesën, duke penguar qasjen, pajtimin dhe zhvillimin në Kosovë", ka thënë ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog.

Ai ka thënë se suksesi i këtij projekti jo vetëm që do të kontribuojë në një Kosovë të pastruar nga minat, por do ta hapë rrugën për zhvillim socio-ekonomik në zonat e kontaminuara më parë. "Përvoja e suksesshme e përpjekjeve të përbashkëta midis BE-së, ShBA-së dhe Norvegjisë tregon një model të suksesshëm bashkëpunimi mes donatorëve në dobi të komuniteteve në Kosovë dhe mund të ketë një ndikim pozitiv në sigurinë dhe zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve të Kosovës", ka thënë Szunyog.

Që nga viti 1999 financimi për këto aktivitete jetike drejtohet nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze. Gjatë dy dekadave të fundit puna humanitare e HALO Trust dhe NPA në Kosovë është mbështetur edhe nga Qeveria e Japonisë, e Zvicrës, e Belgjikës dhe e Holandës.

Si pjesë e këtij projekti do të pastrohen 400 000 metra katrorë tokë të kontaminuar nga minat si dhe 3 600 000 metra katrorë tokë të kontaminuar nga municionet kasetore, me qëllimin përfundimtar për t'u ofruar komuniteteve lokale qasje të sigurt në ato zona.

Këto zona të kontaminuara janë të shpërndara në rezervate natyrore, male, pyje, kullota dhe toka bujqësore, gjë që pengon qasjen në shërbime jetike, burime natyrore dhe hapësira ku mund të zhvillohet turizmi dhe aktivitetet sociale. Për më tepër, përmes kësaj iniciative do të bëhet edhe promovimi i përfaqësimit gjinor të komuniteteve, diversiteti kulturor dhe dialogu.

Përmes këtij granti NPA dhe HALO do të pastrojnë një sipërfaqe prej 4 km² të zonës së kontaminuar. Ata do t'i rritin kapacitetet e tyre operative për 30 për qind me fondet nga BE-ja për zgjerimin e operacioneve në vëzhgim dhe pastrim. Operacionet do të kryhen në zona si Zubin Potok, Leposaviq,



Mitrovicë, Belincë, Rastavicë dhe Kosharë.

BE-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për pastrimin e minave dhe bombave kasetore në të gjithë Kosovën gjatë tre vjetëve të ardhshëm, duke

përmirësuar ndjeshëm sigurinë njerëzore dhe zhvillimin ekonomik, ndërsa e përaftron Kosovën një hap më pranë qëllimit strategjik për të qenë e pastruar nga minat dhe nga mbetjet e municionit kasetor.

Projekti "Veprimi për çminim" është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë gjatë tre vjetëve të fundit midis BE-së në Kosovë, Qeverisë së Kosovës, Norwegian People's Aid (NPA) si dhe HALO Trust.

Osmani dekretoi 21 prokurorë me mandat fillestar

PRISHTINË, 17 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, me propozim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka dekretuar të premtën 21 prokurorë me mandat fillestar për tre vjet, ndërkohë që të ata do të sistemohen në prokuroritë themelore. Në ceremoninë e betimit,

presidentja Osmani ka theksuar se integriteti dhe profesionalizmi i prokurorëve janë elementë thelbësorë për një sistem të drejtësisë që garanton barazinë dhe besimin qytetar. Në këtë kontekst, Osmani ftoi prokurorët e rinj të angazhohen për një sistem të

drejtësisë së pavarur, të pandikuar dhe profesionale. Ndërkaq prokurorët e rinj janë betuar se gjatë kryerjes së detyrave do t'i qëndrojnë kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe do t'i respektojnë rregullat e etikës profesionale.



Mbahet seminari për kultivarët e rrushit rezistent ndaj sëmundjeve

PRISHTINË, 17 MARS - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht Departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë në Rahovec, në bashkëpunim me shoqërinë për prodhimin e Fidanëve të hardhisë "VCR - Raushedo", si dhe përfaqësuesin e kësaj shoqërie për Kosovë dhe Shqipëri "Agroherbal" Sh.P.K., organizuan seminarin me titull "Kultivarë hardhie tejet të qëndrueshëm ndaj sëmundjeve & Klone të përzgjedhura nga kultivarë hardhish shqiptarë". Në fjalën e tij të rastit, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, i përgëzoi organizatorët dhe të pranishmit për punën e tyre si dhe përshëndeti në veçanti akademik Eugenio Sartori, prof. dr. Andrea Shundi dhe agronomin Arif Daçi për sensibilizimin e kultivimit në trojet shqiptare të varieteteve të hardhisë së rrushit rezistente ndaj sëmundjeve. "Kultivimi i hardhisë së rrushit, prodhimi i verës dhe produkteve të tjera nga rrushi dhe vera në Kosovë ngjan me ato të trevave të tjera

shqiptare dhe ballkanike më shumë se 2000 vjet lashtësi të kultivimit të hardhisë. Andaj, duke u nisur nga këto që u thanë në këtë seminar, koleksionet varietore rezistente ndaj sëmundjeve të kultivuara dhe ato që priten të mbillen së bashku me klonet e përzgjedhura të varieteteve autoktone, si Vranç e Dibrak, do të paraqesin një platformë të re për promovimin dhe prezantimin e verërave kosovare në tregun vendor, tregjet rajonale, evropiane dhe botërore", u shpreh ministri Peci. Ai ka theksuar se mbështetja e MBPZHR-së për sektorin e vreshtarisë dhe verëtarisë ndër vite nuk ka munguar. "Nga fillimi i aplikimit të programeve mbështetëse të ministrisë për grante dhe subvencione afërsisht 25 milionë euro janë investuar në këtë sektor. Ministria e Bujqësisë ka investuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përforcimin e regjistrit elektronik të vreshtave dhe sistemin për menaxhimin të cilësisë së verës, duke zbatuar praktikën më të mirë të vendeve



evropiane. Vitin e kaluar është miratuar Ligji për Pijet e Forta Alkoolike, ndërsa Ligji i ri për Verërat ka kaluar në lexim të parë së shpejti dhe ai do të miratohet, e kjo tregon përkushtimin e MBPZHR-së për krijimin e legjislacionit dhe

kompletimin e tij. Andaj, duke parë rëndësinë dhe veçantinë që vreshtat e Rahovecit kanë, nuk është i tepruar propozimi që zona e vreshtave të Rahovecit të shndërrohet në një zonë të mbrojtur nga UNESCO", ka thënë ministri Peci.

Republika e Kosovës ka një sipërfaqe me vreshta rreth 3,461 ha. Shtrirja e vreshtave është e kufizuar në disa komuna, siç janë: Rahoveci, Suhareka, Prizreni, Gjakova, Malisheva, Istogu, Peja e Klina.

Kosova pranon këstin e parë financiar nga BE-ja në vlerë 67.5 milionë euro

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 MARS - Komisioni Evropian kreu disbursimin e mjeteve financiare në vlerën prej 67.5 milionë eurove. Kjo është pagesa e transhit të parë të përkrahjes buxhetore në kuadër të programit vjetor IPA 2023, që në total kap vlerën prej 75 milionë eurove.

Mbështetja e BE-së e plotëson skemën e qeverisë për mbështetje të energjisë, e cila do ta fillojë menjëherë zbatimin e këtyre masave: Mbështetje e drejtpërdrejtë financiare për familjet më të cenueshme dhe më të pafavorizuara; Stimulimi i kursimeve të energjisë nga konsumatorët familjarë; Mbështetja e konsumatorëve individualë familjarë, duke përfshirë konsumatorët e cenueshëm përmes rritjes së



eficiencës energjetike të njësive të banimit dhe ndërtesave; Mbështetja e konsumatorëve

shtëpiakë duke përfshirë konsumatorët e cenueshëm në investimin në pajisje shtëpiake

me eficiencë energjetike dhe sisteme të energjisë së ripërtërishe; Stimulimi i

kursimeve të energjisë nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Qeveria e Kosovës ka njoftuar se do të vazhdojë t'i mbështesë qytetarët dhe t'i lehtësojë pasojat sociale dhe ekonomike për kategoritë më të prekura nga efektet e krizave të shkaktuara nga lufta në Ukrainë përmes një politike të qëndrueshme dhe të besueshme në menaxhimin e financave publike.

Ky është kësti i parë i parave që Kosova i merr nga pakoja e BE-së për mbështetjen për energji për Ballkanin Perëndimor. Pakoja është krijuar nga BE-ja dhe shtetet anëtare të saj për t'i ndihmuar rajonit që ta kapërcejë krizën energjetike dhe rritjen e madhe të çmimeve të energjisë që i ka shkaktuar agresioni i pajustificuar i Rusisë ndaj Ukrainës.

Jepet mbështetja për punëdhënësit privatë që kanë rritur pagat e 17 mijë punëtorëve

PRISHTINË, 17 MARS - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije se të enjten është ekzekutuar mbështetja për punëdhënësit privatë që kanë rritur pagat e 17 mijë punëtorëve. "Është ekzekutuar mbështetja për punëdhënësit që kanë rritur pagat e 16 996

punëtorëve në sektorin privat, masë me të cilën kemi subvencionuar 50 për qind të rritjes së pagës për tre muajt e parë. Me përmbushjen e kësaj mase është shënuar kështu edhe kompletimi i të gjitha masave të Pakos për Përballje me Inflacionin", ka shkruar

Murati në "Facebook". Ai ka theksuar se inflacioni ka rënduar buxhetet e familjeve gjithandej mirëpo, sipas tij, asnjë qeveri e rajonit nuk ka pasur një pako kaq të madhe e kaq gjithëpërfshirëse si Pakoja për Përballje me Inflacionin që ka zbatuar qeveria jonë.



PAS RAMBUJESË E VJENËS, PËR KOSOVËN VJEN OHRI I MAQEDONISË SË VERIUT TË ALI AHMETIT



Ismet SYLEJMANI

Më 18 Mars 2023, e gjithë bota demokratike euroatlantike dhe antieuroatlantike, do të drejtojë sytë nga Ohri i Maqedonisë së Veriut, dhe do të përqëndrohet te kjo ngjarje e madhe!

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian, kanë vendosur që në Ohër, në Maqedoni të Veriut, të zhvillohet një nga evenimentet më të mëdha ndërkombëtare, që në fokus të saj do të ketë arritjen e Marrveshjes Historike, në

mes të Kosovës dhe Serbisë! Më 18 Mars 2023, në Ohër të Maqedonisë së Veriut të Ali Ahmetit, do të zhvillohet një eveniment i madh politik e kombëtar historik për Kosovën dhe Serbinë!

Është hera e parë që lajmi senzacional botëror, nuk paraqitet vetëm pse aty do të mbahen bisedimet në mes Kosovës dhe Serbisë me ndërmejtësime ndërkombëtar, por senzacionale është edhe fakti se kjo do të mbahet në Ohër!

Të gjithë e dimë se kush është qyteti i Ohrit dhe çfarë historie perfaqëson!

Qyteti i Ohrit, është qyteti, ku është arritur Marrveshja Historike e Ohrit!

Në këtë qytet, ku ka zbritur nga malet liridashëse Marrveshja e hartuar nga eksperti amerikan Dr. Paul R. Williams dhe e nënshkruar fillimisht nga Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare

Kombëtare Ali Ahmeti, e cila pastaj është nënshkruar nga Presidenti Boris Trajkovski e Kryeministri i Maqedonisë Lupço Gorgevski, nga Kryetari i LSDM-së Branko Cervenkovski dhe Kryetarët e dy partive politike shqiptare

Ymer Ymeri i PPD-së dhe Arber Xhaferi i PDSH-së!

Gjithashtu Marrveshja është firmosur edhe nga ndermjetësuesit ndërkombëtar, nga ai amerikan James Pardew dhe nga ai europian Fransoa Leotar!

Marrëveshja Kornizë, e njohur si Marrëveshja e Ohrit, u nënshkrua nga partitë më të mëdha politike në vend dhe përfaqësuesve të posaçëm të BE-së dhe SHBA-së, dhe më 13 gusht 2001 u bë përfundimisht Marrveshje Historike dhe njihet si Marrveshja e Ohrit! A do të ketë një përfundim

të tillë edhe për Kosovën e Serbinë, ashtu sikur kishte për UÇK-në e partitë politike shqiptare dhe ushtrinë e partitë politike maqedone, mbetet të shihet, më 18 Mars 2023!

Por një gjë është e sigurtë, se delegacioni i Kosovës është në shtëpi të vëllëzërve të tij! Delegacioni i Kosovës do ta ketë mbrojtjen të trefishtë, edhe të SHBA-së, edhe të BE-së edhe të Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti!

Prishtinë, 17 Mars 2023!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Giresse publikon listën e futbollistëve për ndeshjet e marsit

PRISHTINË, 17 MARS - Ndeshjet e para të ciklit të ri kualifikues për "Euro 2024" po afrohen. Përfaqësuesja e Kosovës do të grumbullohet prej ditës së hënë në hotel "Emerald" për t'i filluar përgatitjet për dy ndeshjet e këtij muaji të cilat janë shumë të rëndësishme në rrugëtimin drejt qëllimit final - kualifikimit në Evropian. Përzgjedhësi Alain Giresse për dy ndeshjet e para kualifikuese kundër Izraelit dhe Andorrës ka ftuar 26 futbollistë. Tani është koha që lojtarët tanë "dardanë" formën e mirë që po e kalojnë në klubet e tyre ta bartin në ekipin përfaqësues dhe të krijojnë një strategji të fortë për ta arritur suksesin historik. Stërvitja e parë zhvillohet në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, të hënë, në orën 15:00, derisa paraprakisht përzgjedhësi Giresse në orën 11:00, në "Emerald", do të paraqitet në

konferencë para gazetarëve. Ndeshjen e parë në kuadër të kësaj fushate kualifikuese "dardanët" e zhvillojnë më 25 mars në Tel-Aviv, ndërsa ndeshjen e dytë më 28 mars në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Lista e futbollistëve

Arijanet Muriq, Samir Ujkani, Visar Bekaj, Mërgim Vojvoda, Florent Hadergjona, Amir Rrahmani, Mirlind Kryeziu, Fidan Aliti, Amar Gerxhaliu, Leart Paqarada, Donat Rrudhani, Betim Fazliji, Ibrahim Dresheviq, Blendi Idrizi, Valon Berisha, Bersant Celina, Florian Loshaj, Florent Muslija, Edon Zhegrova, Elbasan Rashani, Arbnor Muja, Arber Zeneli, Milot Rashica, Zymer Bytyqi, Vedat Muriqi, Albion Rrahmani.



City - Bayern, finalja e parakohshme e Ligës së Kampionëve

NYON, 17 MARS (ER) - Është hedhur shorti i Ligës së Kampionëve në Nyon të Zvicrës. Finalja e parakohshme e kësaj gare është përballja në mes të kampionit të Premierë Ligës, Manchester Cityt dhe Bayern Munchenit. Shorti ka sjellë edhe përballjen e skuadrave italiane në çerekfinale në mes të Napolit dhe Milanit. Reali i Madridit mbrojtjen e titullit e kërkon në ndeshjen ndaj Chelsea, ndërsa Interi ka punë me Benficën. Ndeshjet e para çerekfinale zhvillohen më 11 dhe 12 prill, ndërsa ato të kthimit më 18 dhe 19 prill. Finale para finales do të ketë edhe në gjysmëfinale pasi fituesi i ndeshjes Real Madrid - Chelsea do të përballet me fituesin e duelit Manchester City - Bayern Munchen. Fituesi nga ndeshja Inter - Benfica përballet me Milan - Napoli. Finalja e Ligës së Kampionëve këtë sezon do të luhet më 10 qershor në Stamboll.



Liga e Evropës: Spikatin përballjet United - Sevilla dhe Juve - Sporting

Pasi u mësuan sfidat çerekfinale në Ligën e Kampionëve, në orën 13:00 në

Nyon të Zvicrës është hedhur shorti për çiftet çerekfinaliste të Ligës së Evropës. Këto çerekfinale do të luhet me datë 13 dhe 20 prill, ndërsa gjysmëfinale më 11 dhe 18 maj. Finalja e madhe në Budapest do të luhet më 31

maj. Gjysmëfinalja e parë do të ketë në përballje fituesin e sfidës Juventus - Sporting dhe Manchester United - Sevilla, ndërsa gjysmëfinalja e dytë do të jetë fituesi i sfidës Feyernoord - Roma dhe Leverkusen - Union SG.

ÇIFTET E ÇEREKFINALES:

Manchester United - Sevilla
Juventus - Sporting
Bayer Leverkusen - Union SG
Feyenoord - Roma

Basel - Nice, ndeshja kryesore në Ligën e Konferencës

Pas shortit në Ligën e Kampionëve dhe Ligës së Evropës, është hedhur shorti në Ligën e Konferencës. Ndeshjet e çerekfinaleve do të luhet më 13 dhe 20 prill, gjysmëfinale më 11 dhe 18 maj, ndërsa finalja më 7 qershor. Fituesi ndërmjet Anderlecht - Nice do të përballet në gjysmëfinale me fituesin e ndeshjes Gent - West Ham, ndërsa fituesi i Lech Poznan - Fiorentina do të ndeshet në gjysmëfinale me fituesin e ndeshjes Basel - Nice.

NDESHJET E ÇEREKFINALEVE:

Lech Poznan - Fiorentina
Gent - West Ham
AZ Alkmaar - Anderlecht
Basel - Nice

ÇIFTET E ÇEREKFINALES:

Inter - Benfica
Manchester City - Bayern Munchen
Milan - Napoli
Real Madrid - Chelsea

Denveri kualifikohet në "play-off"

DETROIT, 17 MARS - Ekipi i Milwaukee's u mund me rezultat 139-123 nga Indiana, një humbje që nuk prish aspak planet e skuadrës së Bucksit, në krye të renditjes në Lindje dhe i kualifikuar në "play-off". Tetë lojtarë të Indianas realizuan mbi 10 pikë, duke i bërë të

pavlefshme 25 pikët e Antetokounmpos. Fitore të rëndësishme arriti ekipi i Denverit, që mundi 119-100 Detroitin jashtë fushës, duke u bërë ekipi i dytë që ka siguruar matematikisht fazën "play-off". Nikola Jokiq, protagonist për miqtë, autor i 30 pikëve dhe 10

reboundeve. Sacramento, falë 24 pikëve e 21 reboundeve të Sabonis, mundi me rezultat 101-96 Brooklyn. Fitoi edhe ekipi i Phoenixit, që mundi 116-113 Orlando, sfidë ku Brooker realizoi 19 pikë, por vendimtar ishte stoli i Sunsit me 41 pikë. Toronto mposhti me rezultat 128-111

Oklahoman, ndeshje ku dallimin për ekipin kanadez e bënë Siakami me 25 pikë e Trente me 23 pikë. Rezultatet: Detroit-Denver (100-119), Brooklyn-Sacramento (96-101), Toronto-Oklahoma (128-111), Milwaukee-Indiana (123-139), Phoenix-Orlando (116-113).



Të dielën zhvillohet derbi i Superligës në basketboll

PRISHTINË, 17 MARS - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 26 në Prince Caffè Superligën e Kosovës në Basketboll. Sfida kryesore apo derbi i kësaj jave do të zhvillohet të dielën në mes të Trepçës dhe Pejës. Dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës pritet të dhurojnë spektakël. Mitrovicasit janë në vendin e katërt me 15 fitore e dhjetë humbje, kurse pejanët kanë 18 fitore e shtatë humbje, duke e bërë edhe më interesante këtë sfidë. Ndeshja hapëse do të jetë ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Rahovecit, përkatësisht vendit të shtatë dhe të tetë. Prizrenasit kanë shtatë fitore e 18 humbje, kurse "vreshtarët" katër fitore e 21 humbje, por takimi për vendësit është më i rëndësishëm, pasi duan të



shmangin "play-out"-in dhe të hyjnë në "play-out". Këtë synim e ka edhe Vëllaznimi që ndeshet me kampionin Golden Eagle

Yllin. Kuqezinjtë numërojnë tetë fitore e 17 humbje, kurse therandasit 18 fitore e shtatë humbje.

SUPERLIGA - JAVA 26

TË SHTUNËN TAKOHEN:
17:00 Ponte Prizreni - Rahoveci
19:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli

TË DIELËN TAKOHEN:
17:00 Trepça - Peja
Bashkimi - Sigal Prishtina
(zhvillohet më vonë)

Shqipëria zbardh listën e futbollistëve

TIRANË, 17 MARS - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho, ka shpallur listën me emrat e 23 lojtarëve që do të grumbullohen për ndeshjen e parë në Kualifikueset e "Euro 2024" ndaj Polonisë, që do të luhet më 27 mars. Tre portierët e ftuar janë Etrit Berisha, Thomas Strakosha e Elhan Kastrati, ndërsa në mbrojtje janë Elseid Hysaj, Ivan Balliu, Ermir Lenjani, Adrian Ismajli, Marash Kumbulla e Frederic Veseli. Në mesfushë do të jenë Qazim Laçi, Kristjan Asllani, Klaus Gjasula, Amir Abrashi, Ylber Ramadani, dhe Nedim Bajrami, ndërsa në sulm janë thirrur Sokol Cikalleshi, Myrto Uzuni dhe Taulant Seferi. Trajneri Sylvinho do të dalë në një konferencë për medie të shtunën në ambientet e Shtëpisë së



Futbollit ku do të flasë për zgjedhjet e tij dhe për objektivat në këto kualifikuese dhe sfidën me Poloninë. Sakaq, Kombëtarja do ta nisë grumbullimin të dielën në Tiranë, ndërkohë që në vazhdim do të publikohet edhe agjenda

mediatike dhe stërvitore e kuqezinjve. Sfida Poloni - Shqipëri, e vlefshme për kualifikueset e Evropianit 2024, Grupi E, do të luhet më 27 mars në stadiumin "PGE Narodowy" të Varshavës dhe nis në orën 20:45.

SHKURT

Lajm i keq për Kosovën, Gjermania fton Mërgim Berishën

Edhe pse Kosova është duke e pritur që një kohë të gjatë, Mërgim Berisha do të ftohet nga Kombëtarja e Gjermanisë për ndeshjet e muajit mars, ka njoftuar gazetari i njohur i "Sky Sport" të Gjermanisë, Florian Plettenberg. Gjermania do t'i luajë dy ndeshje miqësore në mars, pasi është organizatore e Kampionatit Evropian dhe nuk merr pjesë në eliminatore. Me këtë rast gjasat që Berisha t'i bashkohet Kosovës shkojnë në një pikë minimale, sidomos nëse paraqitet mirë për Gjermaninë. Vitet e fundit Kosova ka humbur një numër të konsiderueshëm të futbollistëve cilësorë, shumë prej të cilëve po pëlqejnë të luajnë për shtetet e tjera. Ka pasur raste kur edhe ekipet e shpresave të Kosovës janë braktisur për të luajtur për shtete të tjera.

Crystal Palace shkarkon Vieiran

Patrick Vieira më nuk është trajner i Crystal Palaces, pasi skuadra e Premierligës ka vendosur ta pushojë nga puna trajnerin francez. Vieira mori drejtimin e Crystal Palaces në vitin 2021, ndërsa aktualisht ky klub renditet në vendin e 12-të dhe ka tri humbje radhazi.

Conte: Kane nuk largohet nga Tottenhami

Harry Kane nuk do të largohet nga Tottenham Hotspuri. Lajmin e ka konfirmuar trajneri aktual i "Spurs"-it, Antonio Conte. "Mendoj se rreth të ardhmes së Kanes ata që duhet të flasin në këtë rast janë drejtuesit. Besoj se projekti i tyre është që Kane të qëndrojë për gjithë karrierën e tij në Londër. Ai është një sulmues i madh dhe kështu klubi nuk kërkon ta humbasë në asnjë moment. Por, ndonjëherë futbollit është i paparashikueshëm dhe ky vendim i takon Kanes dhe drejtuesve të Tottenhamit", ka thënë Conte.

Ferrari dhe Mercedesi projektojnë shkëmbimin e pilotëve Leclerc - Hamilton

Nga Arabia Saudite, ku këtë fundjavë do të zhvillohet gara e dytë sezonale e botërorit të Formulës 1, qarkullojnë zëra se Ferrari dhe Mercedesi mund të jenë protagonistë jo në pistë, por në merkato. Po përflitet për mundësinë e shkëmbimit të pilotëve, me Charles Leclerc që do të kalojë nga Ferrari te Mercedesi, ndërsa Lewis Hamiltoni do të udhëtojë në drejtimin e kundërt. Këta zëra lidhen me faktin se kontrata e pilotëve skadon në fund të këtij sezoni dhe të dy janë të pakënaqur me makinën që kanë në dispozicion. Leclerc u tërhoq në garën e parë, ndërsa Hamiltonin doli i pesti, pa pasur mundësi të duelojë për podiumin. Për momentin këto janë thjesht zëra dhe asgjë nuk duket e vërtetë, por "ku ka zë nuk është pa gjë". Leclerc ka thënë: "Nuk e di nga dalin këta zëra, ndoshta duan të na vënë në vështirësi. Te Ferrari jemi të gjithë bashkë".

Arteta pas eliminimit nga Sportingu: Tash kemi 11 ndeshje finale

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, është shfaqur shumë i zhgënjyer për eliminimin e skuadrës angleze nga Sportingu i Lisbonës, duke e ndërprerë në fazën e 1/8-ve rrugëtimin në Ligën e Evropës.

Spanjoli deklaroi se ekipi portugez e detyroi kryesuesin e Premierë Ligës të bënte një lojë që ishte jashtë planeve të tij. "Nuk fituam duele në hapësirat e duhura, nuk mund të krijonim mjaftueshëm situata

të vështira në zonën e kundërshtarit. Ne vazhdimisht e dhuronim topin dhe kjo krijoi një ndeshje të hapur që Arsenalit nuk donte ta luante. Ishte një sfidë e vështirë, kishte raste kur nuk ishim në nivelin

tonë. Nuk kishim mundësi ta komandonim ndeshjen, kishim mundësi ta zgjidhnim në kohën shtesë e më pas në penallti. Do të duhet të analizojmë se çfarë nuk shkoi mirë dhe pse nuk ishim aq të

mirë. Duke parë përpara, duke uruar Sportingun, kemi 11 ndeshje finale. E radhës, me Crystal Palacen, është një finale dhe do të duhet të jemi më të mirë se në këtë ndeshje", ka deklaruar Arteta.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Furra e Bukes ARDI" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811448861 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Furra e Bukes ARDI" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811448861 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Furra e Bukes ARDI" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811448861 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Crest Cart" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811889700 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Crest Cart" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811889700 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Crest Cart" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811889700 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ilir Binaku shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional, kursi instalues elektrik me nr. 439/2021

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkohet një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Shqiptarë Humanitare Bëmbësorë e Kosovës "Mëna Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarne Dobrotvorne Udruženje Kosova "Mëna Teresa"
38400 Prishtinë, Rr. Agim Ramadani, pa. Tel:00381 38 542 864, Fax:542 869,
Web site: www.motherteresasociety.org e-mail: mteresce@yahoo.com

CONTRACT NOTICE SUPPLIES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 17/03/2023

Procurement No	Equipment	001	2023	121
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqin.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone: 038-542-865
Email: zefshala@hotmail.com		Fax: 038-542-869
Internet address (if applicable):		www.motherteresasociety.org

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Supplies with Bag Equipment for 350 Women beneficiaries	
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)	
<input type="checkbox"/> Supplies	
Main place of delivery According to the request from Contracting Authorities	
II.1.5) Short description of the object of the contract Supplies with Bag Equipment for 350 Women beneficiaries	

II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) <input type="checkbox"/> 93.000.000.08 <input type="checkbox"/>
II.1.7) Variants are accepted
II.1.8) Division into lots Yes <input checked="" type="checkbox"/> If yes, tenders may be submitted for (tick one) box only <input checked="" type="checkbox"/> All lots
II.1.9) In case of one or more Lots (if applicable) The maximum number of Lots that may be awarded to one Economic Operator is: N/A-

II.1.10) Information about lots (if applicable)	
Lot no	Short description
1	Car Wash Equipment / Pajisjepër auto larje
2	Beekeeping - Package 1 / Bletari - Pako 1
3	Beekeeping - Package 2 / Bletari - Pako 2
4	Greenhouse / Serrë
5	Agriculture - Package 1 / Bujqesi - Pako 1
6	Agriculture - Package 2 / Bujqesi - Pako 2
7	Livestock - Package 1 / Blegtori - Pako 1
8	Livestock - Package 2 / Blegtori - Pako 2
9	Hairdressing / Floktari
10	Manicure & Pedicure / Manikyr&Pedikyr
11	Waxing / Depilim
12	Facial treatment / Tretmanfytyre
13	Equipment's for pastry - Sweet Shop / Pajisjepërpastiqeri - Ëmbëlsira
14	Equipment for fast food / Pajisjepërushqimetëshpejta
15	IT Equipment / PajisjetëTknologjisë Informative
16	Photographer / Fotograf
17	Tailoring - Package 1 / Rrobaqepësi - Pako 1
18	Tailoring - Package 2 / Rrobaqepësi - Pako 2
19	Tailoring - Package 3 / Rrobaqepësi - Pako 3

II.1.11) Estimated contract value: 525,000.00 Euro

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 2 or days 60 (from the contract signature)

or

Starting 17/04/2023

Completion 16/06/2023

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required	No <input type="checkbox"/>
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No <input type="checkbox"/>

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1. License Registration Certificate 2. List of Employees professional and administrative staff Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo (for winner Company) 2. Bank Certificate of active Client 3. Certificate from Justice for Organization and person Representative (for Winner Company) Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity Documentary evidence required Copy of documentary

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No <input type="checkbox"/>
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the supplies	Yes <input type="checkbox"/>

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure	<input type="checkbox"/> Open
---------------------------	-------------------------------

IV.2) AWARD CRITERIA

<input type="checkbox"/> Lowest price

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No <input type="checkbox"/>
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tender dossier: date from 20/03/2023 until 24/03/2023 Payable documents No <input type="checkbox"/>	
IV.3.3) Time limit for receipt of tender: Date 07/04/2023 time 14:00 place Office of Mother Teresa Society Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tender N/A	
IV.3.5) Is tender security needed:	No <input type="checkbox"/>
IV.3.6) Tender validity period: date: 07/04/2023 days 30 or months 1-one	
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 07/04/2023 time 14:30 place MTS Office Pristine	

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in English.

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues